

Vendim nr. 193 datë 23.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 23.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (B) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: BELUL KOKOLLARI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 97, datë 14.04.2022 dhe nr. 141, datë 26.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 188, datë 07.06.2022 dhe nr. 250, datë 27.07.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Interpretimi i neneve 5, 8, pikat 1 dhe 2, 15, pika 1, 16, pika 1, 18, pika 1, 21, 24, pika 1, 25, pika 1, 28, pika 1, 29, pika 3, 31, shkronjat “c” dhe “d”, 32, pika 2, 33, pika 1, 32, pika 2, 33, pika 1, 42, pikat 1 dhe 2, 48, 60, pika 1, 116, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, 116, pika 3, 121, pika 1, shkronja “b” dhe 122, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 7, paragrafi 2, pika 9, i Kodit Penal (KP); nenet 8, 13, 58/b, shkronja “a”, 69, 74, 76, 77, 98 dhe 123 të Kodit të Procedurës Penale (KPP); nenet 29, 39, 40, 41, 42, 43, shkronjat “d”, “e” dhe “f”, 50 dhe 79, pika 9, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Belul Kokollari është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për veprën penale të marrëdhënieve homoseksuale me të mitur, të parashikuar nga neni 100 i KP-së, me viktimë nipin e tij. Procedimi penal është regjistruar në vitin 2021, mbi bazën e kallëzimit të psikologes së shkollës së viktimës së mitur, të paraqitur pranë Komisar iatit të Policisë Berat.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 24, datë 17.11.2021, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit të arrestit në burg, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së. Pas zbatimit të masës së sigurimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 318, datë 25.11.2021, nëpërmjet marrjes në pyetje të kërkuesit, ka verifikuar kushtet dhe kriteret e masës, si dhe nevojat e sigurimit dhe ka vendosur vijimin e zbatimit të saj. Edhe me vendimin nr. 336, datë 09.12.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, ka vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit të arrestit në burg. Kundër këtij vendimi të fundit, kërkuesi ka ushtruar apel në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 25, datë 26.01.2022, ka vendosur miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Më pas, kërkuesi ka kërkuar në gjykatë zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me një masë më të lehtë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 97, datë 14.04.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 188, datë 07.06.2022. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1013, datë 30.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

4. Po kështu, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatë edhe ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 141, datë 26.05.2022, ka vendosur rrëzimin e tij, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 250, datë 27.07.2022. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-995 datë 30.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

5. Në datën 01.07.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, për të cilin në datën 11.09.2024 ka paraqitur edhe aktin “shtesë ankimi”, duke i kërkuar përfundimisht Gjykatës sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procedimit penal i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 6.1. *E drejta për t’u mbrojtur*, pasi kërkuesi është shtetas i Republikës së Kosovës dhe gjykatat shqiptare nuk e kuptojnë gjuhën e shqiptarëve veriorë. Edhe pse kërkuesi ka kërkuar përkthyes, kërkesa nuk i është pranuar nga gjykata.
- 6.2. *E drejta për një gjykatë të caktuar me ligj*, pasi gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion dhe kompetencë në procedimin penal të tij, për një vepër penale të kryer jashtë shtetit nga një shtetas i huaj në dëm të një viktime të huaj.
- 6.3. *E drejta për një gjykatë të paanshme*, pasi gjyqtarët që ka dhënë vendime në procedimin e kërkuesit nuk kanë integritet dhe as arsimin e duhur. Ata kanë zbatuar keq ligjin dhe vlerësuar gabim provat.
- 6.4. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat janë bazuar në prova të pasakta. Kërkuesit nuk i është dhënë mundësia t’i bëjë pyetje viktimës së mitur, dëshmitarëve ose ekspertëve psikologë dhe mjekoligjorë. Janë përdorur prova të falsifikuara, si dhe ekspertë të papërshtatshëm për marrëdhënie seksuale. Viktimës nuk i është bërë analiza e ADN-së për t’u vërtetuar se ishte dhunuar dhe, nëse po, nga kush. Viktima e mitur është pyetur nga psikologë, oficerë të Policisë Gjyqësore, prokurorë dhe gjyqtarë jo të së njëjtës gjini, jo të specializuar për çështje me të mitur, të cilët nuk janë konsultuar paraprakisht me prindërit e të miturit për pyetjet që do t’i bënin.
- 6.5. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi gjykatat e kanë paragjykuar kërkuesin si të huaj, si një malësor, gjë e cila ka ndikuar në vendimmarrjet e tyre.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ai është subjekt i procedimit penal në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore që i përkasin dy proceseve të ndryshme të lidhura me të njëjtin procedim penal, si atij për zgjatjen e afateve të hetimit paraprak, ashtu edhe procesit për zëvendësimin e masës së sigurimit personal. Për sa u përket vendimeve mbi kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit, ato duke qenë se lidhen me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës për efekt të kontrollit nga ana e Gjykatës (*shih vendimet nr. 75, datë 22.12.2015; nr. 40, datë 18.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në lidhje me procesin e zgjatjes së afateve të hetimeve paraprake, kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë rrëzuar ankimin e tij ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake, duke ngritur pretendimet se ato janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor. Lidhur me këtë kërkim, Kolegji vëren se vendimet gjyqësore për afatet e hetimit paraprak nuk janë përfundimtare dhe, si të tilla, i nënshtrohen kontrollit kushtetues në momentin kur çështja gjyqësore e kërkuesit zgjidhet me vendim përfundimtar. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se lidhur me të drejtën kushtetuese të hetimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, legjislacioni në fuqi, konkretisht Kodi i Procedurës Civile, në nenet 399/1 e vijues të tij, parashikon të drejtën e individit për të kërkuar konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave të hetimit në gjykatën e shkallës së parë, mjet i cili duhet të shfrytëzohet përpara se individit t'i drejtohet Gjykatës (*shih vendimin nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kërkuesi edhe pse e ka pasur në dispozicion këtë mjet juridik që garanton të drejtën për proces të rregullt edhe në drejtim të kohëzgjatjes së procedimit penal, nuk rezulton ta ketë përdorur atë. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ai nuk ka shtuar mjetet juridike, ndaj kërkit i tij për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore që kanë refuzuar ankimin ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit paraprak, nuk mund të merret në shqyrtim.

12. Gjithashtu, Kolegji vëren se në përmbajtje të ankimit kushtetues individual, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e lidhur kjo me mungesën e juridiksionit dhe kompetencës së gjykatave shqiptare për të gjykuar veprën penale për të cilën akuzohet, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, e lidhur me mënyrën e marrjes së provave dhe vlerën provuese të tyre. Lidhur me këto pretendime, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me procedimin penal që është duke u zhvilluar ndaj kërkuesit dhe, si të tilla, ai i ka të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike në dispozicion që këto pretendime t'i ngrejë përpara gjykatave të zakonshme gjatë gjykimit të themelit të çështjes së tij, ku mund të parashtrijë si kërkesa, ashtu edhe pretendime në lidhje me sa më sipër, si edhe provat e tij në kundërshtim të akuzës së ngritur nga prokurori. Për rrjedhojë, këto pretendime, në mënyrën se si janë parashtruar nga kërkuesi në këtë ankim kushtetues individual, nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë për sa kohë ato nuk janë vlerësuar dhe nuk u është dhënë përgjigje nga gjykatat e zakonshme në përputhje me kompetencat e tyre dhe në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*. Për rrjedhojë, edhe në lidhje me këto pretendime, Kolegji vlerëson se nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur për shkak të refuzimit të kërkesës për përkthyes. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji thekson se gjuha shqipe është gjuhë zyrtare edhe në Republikën e Kosovës. Për më tepër, nga përmbajtja e ankimit kushtetues individual dhe gjithë kopjeve të korrespondencave të paraqitura personalisht nga vetë kërkuesi në Gjykatë dhe të përpiluara me shkrim dore prej tij, rezulton se ai është njohës i mirë i gjuhës shqipe. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuetit është haptazi i pabazuar.

14. Po në këtë drejtim, Kolegji konstaton se edhe pse objekt i kërkesës është shfuqizimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të faktit, me të cilat është rrëzuar kërkesa e kërkuetit për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, në përmbajtje të ankimit kushtetues individual ai nuk ka parashtruar asnjë argument se cilat të drejta apo liri themelore i janë cenuar atij prej këtyre vendimeve gjyqësore, si dhe nuk ka ngritur asnjë argument faktik për vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin rekursi i tij nuk është pranuar. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky kërkim është haptazi i pabazuar.

15. Ndërsa për sa i përket kërimit tjetër, objekt i ankimit kushtetues individual, për interpretimin e dispozitave ligjore, Kolegji thekson se interpretimi i ligjit material e procedural dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 23, datë 20.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, edhe ky kërkim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.